



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit_ dhe nenit 23 paragrafit 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të të mabjtur me datë 14.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-5254 nga viti 2019, formuar pas denoncimit nr.12-5254/1 me datë 18.11.2019 dorëzuar nga parashtruesi nga **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën 12-5254 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-5254 nga viti 2019, të mbyllet dh të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrusionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita vendimmarrjes.

Sqarim

Lënda me numër 12-5254 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-5254/1 me datë 18.11.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), nga parashtruesi nga

Në denoncim janë theksuar akuza kundër personit nga, për kryerjen e veprës penale ndërtim pa leje sipas nenit 244-a paragrafi 1 nga Kodi Penal, për objekte të ndërtuar në parcela të ndryshme të kadastrës në KK Kisella Vodë 2, për të cilat ndërton pas dorëzimit të kërkesës nga personi i njëjtë zhvillohen procedura për legalizim pranë Komunësë Aerodromit.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merr parasysh akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek PTHP dhe deri tek Komuna e Aerodromit, për mbledhje të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionin për akuzat e lëndës.

Në kërkesë nga Komisioni shtetëror janë dorëzuar lajmërimet me informacionet e kërkuara me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumenatcionit të plotë me të cilën disponon për rastn e lëndës, nga ana e KSHPK është konstatuar kjo:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për procedurë për legalizim të objektit të ndërtuar pa leje të filluar me kërkesë dorëzuar nga personi i përmendur më muajin mars të vitit 2011 deri tek Komuna e Aerodromit, në të cilën nga ana e asaj është dhënë deklaratë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se bëhet fjalë për objekt – kuzhin vere me WC, mirëpo në ndërkohë është ndryshuar gjendja faktike dhe në vitin 2017 me vëzhgin në vendngjarje në procedurë nga ana e komisionit komunal është konstatuar se objekti është bërë përdhese dhe mansarda (shtëpi), që don të thotë është rindërtuar derisa ka zgjatur procedura, pa leje për ndërtim, dhe për atë është përpunuar dhe elaborat gjeodezik i cili është dorëzuar deri tek Komuna;
- Sipas parashtruesit të denoncimit, edhe pse objekti ka qenë i ndërtuar pa leje, Komuna nuk e ka ndërprerë procedurën, nuk e ka rrefuzuar kërkesën e personit të përmendur dhe ka vazhduar procedurën me dhënjën e dokumentit/aktit për të njëjtën, në periudhën Janar-Mars të viti 2017, por është dhënë edhe vendim për legalizim, gjë që është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për procedura me objektet pa leje në përputhje me të cilin për palët e involvuara është paraparë edhe përgjegjësi penale;
- Parashtruesi i denoncimit paraqitet si palë e kyçur në rastin konkret përshkak se objekti i ndërtuar pa leje është ndërtuar në parcela në KK Kisella Vodë 2 dhe atë PK/..... në pronësi të RMV dhenë PK/..... në të cilën edhe ky ka të drejtë pronësi, dhe e njëjta udhëzon edhe për parregullësi në procedurën e udhëhequr për legalizim të ndërtimit pa leje me kërkesë për objekt të PK/..... e cila ka qenë pronësi e njërit nga parashtruesit e denoncimit;
- Në lidhje me rastin e lëndës, parashtruesi u drejtua deri tek PTHP Shkup me kërkesë të veprojnë për denoncimin penal të tyre dhe të ngrisin padi kundër personave të involvuar;
- Me datë 21.05.2020, PTHP e informoi KSHPK se kanë vepruar për denoncimin penal të dorëzuar nga ana e nga me të cilën ato kërkojnë të ngritet padi kundër palëve të involvuara në rastin e lëndës (..... nga), për vepër penale – ndërtim pa leje nga neni 244-a st. 1 nga Kodi penal, sipas të cili është formuar lëndë KO nr./..... pas të cilët është vendosur e njëjta të bashkangjitet me lëndën me numër KO nr./..... formuar nga PTHP në rastin e njëjtë – e cila lëndë ka qenë në fazën e procedurës parahetuese, është bërë kontrollim në përputhje me Ligjin për procedurë penale dhe janë mbledhur dëshmi relevante, dhe kur të merret vendimi përfundimat nga prokuroria publike, të dëmtuarit do të jenë me kohë të informuar.
- Nga ana e Komunës së Aerodromit, me datë 27.05.2020 deri në KSHPK është dorëzuar lajmërim se procedura e lëndës për legalizim në Komunë është udhëhequr periudhë më të gjatë kohore dhe me informacione për gjendjen momentale në lidhje me procedurën me shtojcë janë dorëzuar dokumentacion i madhë. Në lajmërimin theksohet se kjo procedurë ka filluar me kërkesë nga data 24.03.2011, dorëzuar nga personi nga e në të cilën është dhënë pëlqim urbanistik për objekt pa leje nga data 09.01.2017 dhe vendim për caktim të statusit juridik të objektit pa leje nga data 16.01.2017 për shtëpi banimi në PK/..... KK Kisella Vodë 2 si dhe pëlqim urbanistik për objekt pa leje me datë 27.01.2017 dhe vendim për caktim të statusit juridik të objektit pa leje me datë 03.03.2017 për shtëpi banimi në PK/..... dhe PK/..... KK Kisella Vodë 2
- Në lidhje me kërkesën për legalizim të dorëzuar nga personi i përmendur, nga ana e parashtruesit të denoncimit deri te KSHPK është mosmarrveshje në 2016, 2017 dhe 2018 para gjykatës administrative e cila ka vepruar pas padive të dorëzuara dhe ka marrë verdikt me të cilën janë rrefuzuar si të pa baza, dhe të cilën u bënë të plotfuqishme në vitin 2017 dhe 2018.

Gjithashtu, për këtë rast veproi edhe Komisioni shtetëror për vendimmarrje të shkallës së dytë në fushën e inspektimit vëzhgues dhe procedurë për kundërvajtje, pas ankesës është dorëzuar nga ana e ndihmës-udhëheqës i Sektorit për çështje komunale, urbanizëm, mbrojtje dhe përmirësim të mjedisit jetësor pranë

Komunës, kundër vendimit nga data 27.11.2019 marrë nga ana e inspektorëve administrativ nga Inspektorati shtetëror administrativ gjatë inspektimit të jashtëzakonshëm në muajin Nëntor të viti 2019 në lidhje me vendimin e marrë nga Ministria e transportit dhe lidhjes me datë 08.10.2019. në lidhje me ankesën e dhënë, me datë 20.02.2020, ky Komision shtetëror morri Vendim se e njëjta rrefuzohet si e pa bazë.

Ajo çka ka të bëjë me procedurë për shtëpi banimi në PK/..... KK Kisella Vodë 2, nga ana e Ministrisë së transportit dhe lidhjes deri tek Komuna e Aerodromit është marrë vendim me datë 03.04.2020, pas ankesës së personit nga, me datë 03.01.2020 kundër vendimit me datë 26.12.2019 marrë nga Kryeprefekti i Komunës dhe me të cilë i është rrefuzuar kërkesa e dhënë me datë 12.12.2018 për vendosjen në vulë të plotëfuqishme të vendimit për caktim të statusit juridik të objektit pa leje me datë 16.01.2017. Me marrjen e vendimit numër UP 2 nr/..... me datë 03.04.2020, Ministria e transportit dhe lidhjes ia pranoi ankesën personit nga dhe e shfuqizoi vendimin e marrë nga ana e Kryeprefektit të Komunës së lëndës.

- Në procedurë për shtëpi banimi në PK/..... dhe PK/.... KK Kisella Vodë 2, nga ana e Ministrisë së transportit dhe lidhjes deri tek Komuna e Aerodromit është dorëzuar vendim me datë 03.04.2020, pas ankesës së personit nga, me datë 03.01.2020, kundër vendimit me datë 28/12.2019 marrë nga Kryeprefekti i Komunës dhe me të cilën është shfuqizuar pëlqimi urbanistik për objekt pa leje me datë 27.02.2017 dhe vendimit për caktim të statusit juridik të objektit pa leje me datë 03.03.2017. Me marrjen e vendimit numër UP 2 nr./.... me datë 03.04.2020, Ministria e transportit dhe lidhjes ia pranoi ankesën personit nga dhe e shfuqizoi vendimin e marrë nga ana e Kryeprefektit të Komunës së lëndës.
- Lënda pas procedurës për të dy shtëpitë e banimit, për momentin, në Komunën e Aerodromit, ka arritur deri në fazë të vënjes së vulën për plotëfuqishme të vendimeve për caktim të statusit juridik të objektit pa leje.

Në bazë të tërë kësaj që u konstatua më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit caktoi se në rastin e lëndës veprojnë organe tjera kompetente (PTHP dhe Komuna e Aerodromit) para të cilëve procedura ende është në vazhdim, me çka vlerësoi se Komisioni shtetëror nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të vetin në rastin e lëndës, procedura për lëndën, ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi në dispozitë të këtij vendimi

Është vendosur me datë 14.12.2020 me numër 12-969/6

Dorëzuar deri: Arkiva; parashtruesi
Pas përfundimit të KSHPK
Punoi: J.C., këshilltarë
Miratoi: S.P.D., anëtarë i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRO R PËR
PARANDALIM TË
KORRUPSIO NIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**